



REPUBLIKA E SHqipërisë  
MINISTRIA E KULTURËS

## KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 268 Prot.

Tiranë, më 02.032017

### VENDIM Nr. 31, datë 01.03.2017

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 3 të datës 01.03.2017, pasi shqyrtoi Raportin paraprak mbi sondazhin arkeologjik në kuadër të *projektit "Sheshi para hyrjes së Portit të Durrësit"* dhe propozimin për kryerjen e gërmimit arkeologjik në krahun perëndimor, poshtë rrugës tregtare dhe në krahun verior në tre sektorë të bastionit romako-bizantin (në lindje mbi strukturat e Portës Antike, në qendër të linjës, në perëndim pranë Torrës Veneciane), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë dhe DRKK Durrës.

### VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin paraprak mbi sondazhin arkeologjik, në kuadër të *projektit "Sheshi para hyrjes së Portit të Durrësit"*, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë dhe DRKK Durrës.
2. Të kryhet nga Instituti i Arkeologjisë gërmimi arkeologjik, nën mbikëqyrjen e ASHA dhe DRKK Durrës, për gjurmimin e linjës periferike perëndimore të bastionit, të zbuluar nga sondazhi arkeologjik, përgjatë bulevardit "Epidamn", deri në pikëtakimin me murin bizantin, me qëllim evidentimin e planimetrisë ndërtimore të tij.
3. Të kryhen nga ky Institut sondazhe arkeologjike, nën mbikëqyrjen e ASHA dhe DRKK Durrës:
  - Në qendër të linjës të murit bizantin, në kryqëzim me bulevardin "Epidamn"
  - Pranë Portës Antike të murit bizantin,me qëllim verifikimin e kronologjisë ndërtimore të murit bizantin.
4. Raporti i proceseve arkeologjike të sipërcituara të kalojë për shqyrtim dhe vendimmarrje në KKA e radhës.
5. Të gjitha gjetjet arkeologjike të cilat do të dalin, të dokumentohen dhe më pas të depozitohen pranë Muzeut Arkeologjik, Durrës.
6. Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar) Investitori të mbulojë shpenzimet për kryerjen e proceseve arkeologjike të sipërcituara.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)



7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
8. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FERXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**  
**RUDINA ZOTO**